ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: ***AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS***

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: ***124000-23-2667-2-2-1*** *nr.brend*

Sa i përket tenderit për ***"Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare të ASK-së"***

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NTSH "BESI"
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Lidhja e Prizrenit Nr.23
(Adresa)

Prishtine — ***10000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*

049/123981 — ***n/a***
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Besim Kozmaqi_
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
servisbesi@hotmail.com
(Adresa elektronike)

05.07.2023
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- *Njoftimi per kontrate 29.03.2023*
- *Njoftimi per Vendimimin e AK 22.06.2023*
- *Pergjegjeja ne kerkesen per Rishqyrtim 29.06.2023*
- *Afati i fiindit i dorezimit te tenderit 18.04.2023 ora 14:00*
- *Kriteret e Dhenies se tenderit: Tenderi i përgjegjshëm me* ***Çmimin më te ulët*** ☒ *apo Tenderi i përgjegjshëm* ***ekonomikisht më i favorshëm i*** *përcaktuar sipas kriterit të* peshës të përshkruar në Aneksin 6 ☐

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.
Me daten 26.06.2023 kemi bere Kerkese per Rishqyrtim dhe AK e refuzon kerkesen ton per Rishqyrtim duke refuzuar kerkesen per Rishqyrtim me arsyetim se ne baze te rekomandimeve te komisionit per vleresim, krahasimin dhe ekzaminimin e ofertave ka ardh ne perfundim te njejte si ne njoftimin e pare.
Nga ky konstatim verejme se komisioni i njejte ka punuar si ne vleresim ashtu edhe ne rivleresim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- **Neni 6.-Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**
- Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Te RRPP
- **Neni 59. I LPP-se- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Shoqëria NTSH "BESI" me seli në Prishtinë **(me tej: Kerkuesi),** brenda afatit ligjor te paraparë më dispozitën e Nenit 108 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 per Ankese, respektivisht, brenda afatit të lënë për kerkese paraqet këtë:

ANKESË

per shkak te:

- Konstatimit te gabuar te gjendjes faktike
- Aplikimit te gabuar te te drejtes materiale

Më të cilin Kerkese **Kerkuesi godet në tërësi njoftimimin per tenderuesin e elimuar, *përshkruar me lartë,* si akt administrativ të paqëndrueshëm, të ngutshëm, subjekiv dhe absolutisht të pabazë dhe**

Propozon që

Kerkesen e paraqitur nga Kerkuese ta **miratoj** si të bazuar në Ligj, Vendimin per tenderuesin e eliminuar ta **ABROGOJ,** respektivisht, **ANULOJ** –, njoftimimin e AK per konstatimin e komisionit i cili rekomandon anulimimin e procedurave te metejme per tenderin e lartecekur **TA ANULOJ** dhe AK te vazhdon me tutje me proceduren e prokurimit per projektin e lartepermendur.

Me daten 22.06.2023 nepermjet platformes elektronike te KRPP-se e-prokurimi kemi pranuar letren standarde per tenderuesin e eliminuar si dhe njoftimin mbi Vendimin e AK i cili anulon kete procedure te prokurimit. Ne letren standarde per tenderuesin e eliminuar kompania e jone eliminohet me nje arsyetim qe nuk ka te beje fare me tenderin e larte permendur as nga aspekti administrative e as nga aspekti teknik dhe i çmimit.

Mbrenda afateve ligjore kemi bere kerkese per Rishqyrtim mirepo AK e refuzon kerkesen tone per rishqyrtim me justifikim:- refuzohet kerkesa per rishqyrtim duke mos cek fare arsyen a eshte me baze apo pa baze por vetem thirret ne rekomandimet e komisionit per vleresim gjegjesisht rivlersim.

PRETENDIMI ANKIMOR.- NENI 59.- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.-Komisioni i vleresimit ka pase per qellim qe tenderet te ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do t'i epet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. ***Kete qellim komisioni i vleresimit nuk e ka kryer pasi per mendimin tone ai ka qene subjektiv dhe jo profesional qe arsyen nuk e dim.***

- **Sipas nenit Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve** pika 40.1 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve bëhet në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP.
- 40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit; b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit; c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.
- **40.12 Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkese apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit**.
- **40.13 AK do t'i vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kritereve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.**

Komisioni i vleresimit i AK **nuk eshte marr fare me dosjen tenderit** qe eshte publikuar me njoftim te kontrates me kriteret qe jane kerkuar mirepo eshte marre per nje çeshtje qe nuk ka te beje fare me njoftimin per kontrate.
Kompania e jone sa i perkete pretendimeve te AK ne lidhje me servisimin e nje veture 3Z-320-01 qe ka ndodh ne qershor te vitit 2022 dhe Tetor te vitit 2022 qenka jo funksionale kete informate per here te pare e kemi ne letren standarde te tenderuesit te eliminuar perndryshe kompania e jone nuk ka njohuri per pretendimet e AK..
Kompania e jone ka pas nje kontrate me AK kontrata nr.04-052-3347 date 29.10.2019 me ASK me kohe zgjatje 36 muaj nga data 28.10.2019 deri 27.10.2022 dhe gjate kesaj periudhe kompania e jone asnjehere nuk ka pas ndonje mosmarreveshje per realizimin dhe implementimin e kontrates. Kompania e jone te gjitha kriteret qe kane qene te parapara ne KPK (kushtet e pergjithshme te kontrates) dhe KVK(Kushtet e veçanta te kontrates) i ka implementuar ne perpikemeri.
AK -Agjencia e Statistikave te Kosoves dhe OE -NTSH "BESI" nuk ka pas asnjehere vrejtje rreth servisimit te automjeit te lartepermnedur. Te vetmin korospondim ne lidhje me Automjetin 3Z-320-01 e kemi me daten 01.03.2023 ku na si OE ia kemi drejtuar menaxherit te kontrates Hajriz Beqirit nje shkrese ku kemi kerkuar leje a te servisohet automjeti i lartepermendur apo jo pasi kishin kaluar 66 dite prej qe e kishin dorezuar automjetin te servisi i jone dhe na kemi kerkuar qe te na japin leje per Servisim apo jo ose jemi deklaruar ejani dhe merrni automjetin me qellim qe te na lirohet parkingu i automjeteve.(shtojce e-maili drejtuar Hajriz Beqirit). Z.Hajriz ju ka drejtuar Habib Stranes, Ilir Berisha, Melihate Tahirit, Idriz Nikçiku (shtojce e-mail-i)ku ka kerkuar qe te me kthehet pergjegjeja çka me ndermarr ne kete drejtim. Prandaj me pergjegjesi te plote deklarojme se kompania e jone asnje komunikim tjeter nuk ka pas rreth servisimit te ketij automjeti.
Ne asnjehere nuk kemi pas kerkesa te bazuara ne nenin 18 te KPK-Permiresimi i defekteve nga AK gjegjesisht nga Projekt menaxheri i kontrates dhe per neve konstatimet e komisionit jane te pabaza dhe te qellimshme . Si eshte e mundur qe asnjehere kompania e jone nuk ka pas ndonje shkres zyrtare ndonje e-mail nga menaxheri i projektit apo nga ASK ne lidhje sherbimet e kryera . Nese ata kane pas shqetesim pse nuk kan ndermarr masa per nderprerje te kontrates te percaktuar ne KPK neni 9 kur kan ndodhur servisimet.
Per kompanine tone ne kete faze te tenderimit te dalin konstatime te tilla jane te pabaza dhe subjektive te qellimshme, pasi kompania e jone i ka plotesuar te gjitha kriteret e kerkuara administrativisht, teknikisht dhe çmim sipas DT
Komisioni i vleresimit ka pas per detyre qe ti vleresoj dokumentacionin e OE i cili ka aplikuar ne kete tender e jo te mirret me performancen se si ka ndodhe ne realizimin e nje projekti ne te kaluaren qe per mendimin tone eshte subjektiv
Bazuar ne te gjitha qe u ceken me larte kompania e jone i ka plotesuar te gjitha kerkesat konform njoftimit per kontrate dhe dosjes se tenderit dhe kërkoi nga ana juaj qe Ankesen tone ta shqyrtoni me kujdes dhe njëherit te aprovoni si të bazuar duke marr:

VENDIM

APROVOHET si e bazuar Ankesa e OE NTSH "BESI" ." lidhur me tenderin : ***"Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare të ASK-së"*** **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK . Te anulon vendimin per anulimin e kesaj procedure te prokurimit.

ANULON njoftimin per tenderuesin e eliminuar

SHPERBLEN me kontrate OE NTSH " Besi" pasi tederi i jone te gjitha kriteret e kerkuar i plotesone ne tersi, administrativisht, teknikisht dhe me çmimin më te ulët ne poentim.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*